

VENDIM
Nr. 264, datë 25.3.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I
VARREZAVE KATOLIKE, FSHATI GURËZ, KOMUNA FUSHË-KUQE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave katolike, fshati Gurëz, Komuna Fushë-Kuqe.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Komunës Fushë-Kuqe.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës përkatëse për sipërfaqen 4 000 (katërmijë) m², tokë arë, në vlerë në përgjithshme të shpronësimit prej 1 112 000 (një milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 112 000 (një milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë shpërballohet nga të ardhurat e Komunës Fushë-Kuqe, planifikuarnë buxhetin e saj.

5. Shpenzimet procedurale të përballohen nga Komuna Fushë-Kuqe.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tetremuj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Komunën Fushë – Kuqe të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga joku komunë.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 4000 (katërmijë) m², tokë arë, përzgjerimin e varrezave katolike, të fshatit Gurëz, të bëhet në favor të Komunës Fushë-Kuqe.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komuna Fushë-Kuqe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË
SHPRONËSIMIT TË TOKËS ARË, QË DO TË PËRDORET PËR "ZGJERIMIN E VARREZAVE KATOLIKE",
KOMUNA FUSHË-KUQE**

Nr	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Sip/m ²	Çmimi/lekë	Vlefte/lekë	Nr. i pasurisë	Lloji i dokumentit
1	Ardian Xhev Hima	1890	4 000	278	1 112 000	8/47.	Vërtetim pronësie
Totali					1 112 000		